



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 120, datë 30.06.2021

**PËR
REVOKIMIN E LICENCËS PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARINË SI VLERËSUES
DËMESH NË SIGURIME**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 228, pika 1, germa e, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Në bazë të nenit 226 e vijues, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti licencon vlerësuesit e dëmeve në sigurime.

Z. Marsel Kita është licencuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve materiale dhe shëndetësore sipas licencës nr. 160, datë 26.02.2018.

Vlerësuesi, me shkresën nr. 1469 prot., datë 03.06.2021 ka depozituar në Autoritet kërkesën për heqjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë si vlerësues dëmsh në sigurime, si rrjedhojë e mos ushtrimit të aktivitetit, si dhe ka depozituar licencën me nr. 160 datë 26.02.2018.

Kërkesa për heqje dorë vullnetarisht nga ushtrimi i veprimtarisë, përbën shkak për revokimin e licencës sipas nenit 228, pika 1, germa e, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të nenit 9, pika 1, germa h, të Rregullores nr. 85, datë 03.07.2017 “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, e ndryshuar.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Bazuar në nenin 228, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, revokimin e licencës nr. 160, datë 26.02.2018, të z. Marsel Kita, për të ushtruar veprimtarinë si vlerësues dëmsh në sigurime.**
- 2. Ngarkohen Departamentet përkatëse, për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE